



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __. __. 2025

VENDIM

Nr.03 datë 24.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2024**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z. Gentian	Sala	Kryetar
Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
Z. Lorenc	Bako	Anëtar
Z. Bleron	Dokle	Anëtar
Z. Armer	Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 24.04.2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Kabinetit të Kryetarit të KD, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 7 e nenit 13, dhe pika 1 e nenit 15, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Neni 8 i ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.
3. Vendimi nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, i Kuvendit të Republikën e Shqipërisë.

4. Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Për Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, e ndryshuar, e Këshillit Drejtues të AKEP.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projektraporti i Veprimtarisë së AKEP për vitin 2024;
2. Projektvendimi i Këshillit Drejtues për miratimin e “Raportit të veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024”.

VËREN:

1. Projektraporti i paraqitur pasqyron në mënyrë të plotë dhe korrekte veprimtarinë e AKEP për vitin 2024 dhe është hartuar bazuar në raportimet e bëra nga secila prej Drejtorive të AKEP mbi veprimtarinë e kryer përgjatë vitit.

Gjithashtu dokumenti përmban edhe çështjet e detyrueshme për raportim të përcaktuara në vendimin nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

2. Përmbajtja e projektraportit përmbush kërkesat ligjore të përcaktuara në:

- i. Nenin 13 të ligjit nr. 54/2024, të sipërcituar
- ii. Nenin 8 të ligjit nr. 46/2015, të sipërcituar
- iii. Vendimin e Kuvendit të RSH nr. 134/2018, të sipërcituar
- iv. Rregulloren e Brendshme të AKEP, të sipërcituar

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues pasi e gjen Projektraportin në përputhje me kërkesat ligjore, në mbështetje të pikës 7 të nenit 13, të pikës 1 të nenit 15, të ligjit nr.54/2024 si dhe Rregullores së Brendshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të dërgojë “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024”, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe një kopje e tij, t’i dërgohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ky vendim publikohet në faqen e internetit të AKEP, së bashku me “Raportin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024”.
4. Ngarkohet Kabineti i Kryetarit të KD për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka